



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primijsno/Prodato Received/Delivry	23.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	3674/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.433/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.433/2022 të datës 29.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër Vendimit me numër protokolli 2266-KOM të datës 08.04.2022 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.06.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.433/2022 e datës 29.04.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 2266/KOM i datës 08.04.2022 i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për dy (2) muaj"

### A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA) në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 29.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2526/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 2266-KOM të datës 29.04.2022 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për dy (2) muaj".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.05.2022 ka



proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa Këshilli me datë 11.05.2022 ka pranuar vetëm shkresat e lidhur me çështjen në procedurë.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes me Vendimin Nr.55/2022 të datës 09.06.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.433/2022 të datës 29.04.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesa me numër protokollit 2526/2022 të datës 29.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 08.04.2022; Kërkesën për pushim vjetor të ankuesit të datës 08.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 29.10.2021 të R. A drejtuar ankuesi ; Shkresën e datës 12 dhe 14. 03.2022; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të R.A drejtuar ankuesit lidhur me ngritjen e procedurës disiplinore; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të R.A drejtuar komisionit disiplinore; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të A. M drejtuar Z.D; E-mailin zyrtar të datës 17.03.2022 i drejtorit Z.D drejtuar A.M ; E-mailin zyrtar të datës 09.03.2022 i A.L drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 07.03.2022 të ankuesit drejtuar A.L; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022 të A.M drejtuar A.A K.th dhe ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 02.03.2022 i sekretariatit Koordinues të Qeverisë; E-mailin zyrtar të datës 23.02.2022 të sekretariatit Koordinues të Qeverisë; Ndryshim plotësimin e Aktit të Emërimit i K.R. të datës 03.09.2014; Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 03.09.2014; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i K.R. të datës 07.02.2022; KIESA plani i punës 2022; E-mailin zyrtar të datës 01.11.2021 të F.P drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 29.10.2021 të ankuesit drejtuar F.P; E-mailin zyrtar të datës 25.02.2022 të ankuesit drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 29.03.2022 të ankuesit drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të A.M përfaqësuesit të KIESA-s drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 17.03.2022 të drejtorit Z.D drejtuar A.M përfaqësuesit të KIESA-së; E-mailin zyrtar të datës 09.03.2022 të A.L drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022 të A.M drejtuar R.A ; E-mailin zyrtar të datës 02.03.2022 Procesverbalin e datës 01.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.05.2022; Përgjigje në ankesë të datës 11.05.2022; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të kryesueses së komisionit disiplinore drejtuar menaxheres së personelit A.D; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të përfaqësuesit të KIESA-s drejtuar R.A; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të përfaqësuesit të KIESA-s drejtuar R.A; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të përfaqësuesit të KIESA-s drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 17.03.2022 të drejtorit Z.D drejtuar përfaqësuesit të KIESA-së; E-mailin zyrtar të datës 07.03.2022 të drejtorit Z. D drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022 i përfaqësuesit të KIESA-s drejtuar R.A; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të A.M përfaqësuesit të KIESA-s drejtuar Z.D ; E-mailin zyrtar të datës 17.03.2022 i drejtorit Z.D drejtuar përfaqësuesit të KIESA-s A.M; E-mailin zyrtar të datës 09.03.2022 A.L drejtuar ankuesit ; E-mailin zyrtar të datës 07.03.2022 të drejtorit Z.D drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022 i përfaqësuesit A.M drejtuar R.A; E-mailin zyrtar të datës 29.03.2022 të ankuesit drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të përfaqësuesit A.M drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 21.02.2022 të ankuesit drejtuar kompanive pjesëmarrëse në panair; E-mailin zyrtar të datës 29.10.2021 të R.A drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 02.02.2022 drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 17.03.2022 të N.M drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të kryesueses së komisionit disiplinore drejtuar R.A A.D dhe M.S; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të R.A drejtuar anëtareve të

Komisionit Disiplinor; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të Kryesueses së Komisionit disiplinore drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të R.M drejtuar Komisionit Disiplinor; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të përfaqësuesit të KIESA-se drejtuar R.A; E-mailin zyrtar të datës 18.03.2022 të përfaqësuesit të KIESA-se drejtuar Z.D; E-mailin zyrtar të datës 17.03.2022 të drejtorit Z.D drejtuar përfaqësuesit të KIESA-s; E-mailin zyrtar të datës 09.03.2022 të A.L drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 07.03.2022 të drejtorit Z.D drejtuar ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 07.03.2022 të ankuesit drejtuar A.L; E-mailin zyrtar të datës 04.03.2022 të përfaqësuesit të KIESA-së drejtuar R.A, ankuesit dhe K.TH; E-mailin zyrtar të datës 31.03.2022 të Drejtorit Z.D drejtuar kryesueses së Komisionit Disiplinor; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të Kryesueses së Komisionit Disiplinor drejtuar Drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 01.04.2022 të Drejtorit Z.D drejtuar Kryesueses së Komisionit Disiplinor; E-mailin zyrtar të datës 01.04.2022 të Kryesueses së Komisionit Disiplinor drejtuar drejtorit Z.D; E-mailin zyrtar të datës 30.03.2022 të R.A drejtuar antarëve të Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e datës 07.04.2022; Procesverbalin e datës 06.04.2022; Procesverbalin e datës 01.04.2022; Procesverbalin e datës 01.04.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit  
**SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë rezultoni se ankuesi është i punësuar në Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (tuje KIESA) në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe se i njëjti sipas Ndryshim/Plotësim të Aktit të Emërimit të datës 03.06.2014 ushtron pozitën "Zyrtar i Lart për Promovim të Eksporteve" në Sektorin për Promovim të Eksporteve.

Ankuesi më datë 07.03.2022 përmes emailit zyrtar ka parashtruar kërkesë për aprovim të udhëtimit zyrtar për pjesëmarrje në Panairin "Food Expo Greece 2022 datë 10-15.03.2022". Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA përmes emailit të datës 07.03.2022 nuk ka aprovuar kërkesën e ankuesit, duke njoftuar njëkohësisht se përfaqësimi i KIESA-së në këtë panair do të behët nga Drejtori i Departamentit për Promovim të Sektorit Privat.

Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi më datë 08.03.2022 ka bërë kërkesë për pushim vjetor për periudhën nga data 11.03.2022 deri 15.03.2022, e aprovuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit. Ky i fundit më datë 30.03.2022 bazuar në propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA-së ka proceduar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër protokolli 2266/KOM të datës 08.04.2022 ka shpallur ankuesin përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 4, nenin 5 dhe nenin 10 të Rregullores (QRK)-Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 4, nenin 5 pika 1.1 dhe nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore "Ndalesë prej 20% të pagës mujore bruto për dy (2) muaj".

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i njëjti nuk ka bërë ndonjë shkelje disiplinore duke shtuar se: ka qenë në pushim vjetor dhe së bashku me disa shokë kemi udhëtuar për Selanik, ku meqenëse mbahej panairi ' në cilësi të vizitorit kemi vizituar këtë panair më datë 11.03.2022. Kam biseduar më përfaqësuesit e kompanive vendore pjesëmarrës në këtë panair, pastaj jam

larguar dhe së nuk kam qenë i vetëdijshëm se mund ta anashkaloj hirarkinë më pjesëmarrjen time në panair. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar dispozitat e nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmi.* Ndërlidhur me këtë, sipas nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë shkelje të rënda disiplinore cilësohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë”.

Rrjedhimisht në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në provat materiale lidhur me këtë çështje, Kolegji ka konstatuar se pjesëmarrja e ankuesit në panairin “*Food Expo Greece 2022*” i mbajtur nga data 10.03 deri 15.03.2022, përkundër mos aprovimit të kërkesës së tij për pjesëmarrje dhe përfaqësi të organit të punësimit, konsiderohet moszbatim i vendimeve dhe politikave të udhëheqësve drejtues gjegjësisht konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, mbi këtë bazë rezulton se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejt gjendjen faktike si dhe ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafi 3 dhe nenin 50 paragrafi 2 dhe 3 të këtij Ligji, me të cilin theksohet se: *neni 48 paragrafi 3 ...3: Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor..... neni 50 paragrafi 2 dhe 3: 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji., e si rrjedhoja Kolegji konstaton së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit.*

Bazuar si me sipër, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.433/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit [REDACTED]
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të KIESA-së;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

